




Funded by
the European Union

RAPORT ANALITIK

Nxënësit/et dhe pandemia: Përvoja
mësimore virtuale kundrejt asaj reale



EduPod 1



KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Projekti *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - shkurt **IDEA 2022**, financohet nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe vihet në zbatim nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit, projekti synon të identifikojë problematikat e fushës së arsimit në Kosovë duke zgjeruar hapësirat për debat publik me anë të shfrytëzimit të teknologjive inovative siç janë podcastet. Në këto diskutime janë të përfshira palë kyçe në sistemin arsimor, si nxënës/e, mësues/mësues/e, prindër, politikëbërës etj. ku u jepet mundësia për të ballafaquar mendimet dhe pikëpamjet e tyre.

Seria e podcasteve **EduPod** (shkurtesë e *Education Podcast*) është e para e llojit të vet në Kosovë, si podcasti i parë me karakter edukativo-arsimor i cili trajton çështjet e arsimit në këtë formë. Synohet që me anë të EduPod të shtrihet sa më gjerë debati rreth arsimit dhe të zgjerohen hapësirat për të dëgjuar dhe përfshirë mendimet e të gjitha palëve në arsim, me fokus të veçantë tek nxënësit/et. Këto raporte analitike janë përmbledhje e diskutimeve dhe rekomandimeve të dala nga podcastet e realizuara.

Design: **envinion**:

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - **IDEA 2022**, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritetet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.



RAPORT ANALITIK

Nxënësit/et dhe pandemia:
Përvoja mësimore virtuale
kundrejt asaj reale

Hyrje

Podkasti i parë me karakter specifik edukativo-arsimor në Kosovë, i quajtur “EduPod”, u realizua më 23 mars 2022 në kuadër të projektit *Zhvillimi Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development for Education Advancement – IDEA 2022*, i cili financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës, KEC. Projekti IDEA 2022 synon përmirësimin e cilësisë së arsimit përmes identifikimit dhe trajtimit të çështjeve të arsimit në Kosovë me anë të debateve publike me bazë të gjerë. Ky podkast, i pari prej një serie podkastesh të planifikuara gjatë këtij viti programor, ishte i konceptuar si bashkëbisedim mes palëve të ndryshme të përfshira në sistemin arsimor në Kosovë, ku pala kyçe është nxënësi/ja, pastaj mësimdhënësi/ja dhe prindi.

Nxënësit/et janë përdoruesit/et parësorë/e dhe njëkohësisht përfundimtarë/e të produkteve të arsimit, dhe njëkohësisht janë pala që ka potencialin më të madh për të ofruar kontribut direkt lidhur me mënyrat e trajtimit të sfidave. Një prej qëllimeve të podkastit në fjalë ishte pikërisht zgjerimi i hapësirës për debat publik, duke u dhënë mundësinë vetë fëmijëve të shprehen rreth impaktit të mësimin online gjatë pandemisë. **Mësimdhënësit/et** janë ata/ato që mbartin barrën e rëndësishme të përcimit të dijeve në institucionet edukativo-arsimore. Në mënyrë të veçantë, ata/ato është dashur t’i adaptohen me shpejtësi mësimin online, pavarësisht nga fakti se shumë prej tyre nuk kanë pasur njohuritë dhe përvojën e mjaftueshme për të përdorur teknologjinë e duhur. Nga ana tjetër **prindërit** janë përballur me sfida të tjera gjatë shkollimit të fëmijëve të tyre nga shtëpia, ku prindi është dashur të ofrojë mbështetje për fëmijën në forma kryesisht spontane. Krijimi i kushteve për mësim në distancë, sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme teknologjike dhe qasja në internet janë vetëm disa prej faktorëve që kanë ndikuar në këtë situatë. Duke pasur parasysh temën e debatit, në podkast ishte e ftuar edhe një **eksperte e mësimin në distancë**, meqenëse arsimit në distancë nuk shihet më vetëm si një metodë e përdorur për shkak të pandemisë, por gjithnjë e më shumë po konsiderohet pjesë e pandashme e praktikave edukativo-arsimore në shkallë globale.



Pjesëmarrëset në diskutim ishin:

- Lisa Lohaj,** nxënëse e klasës së 8-të në shkollën “Model” në Prishtinë;
- Arta Demolli,** arsimtare e lëndës së Gjeografisë në shkollën “Model” në Prishtinë;
- Anita Plakolli,** anëtare e kryesisë së Këshillit të Prindërve për Komunën e Prishtinës dhe Drejtoreshë për Zhvillim në organizatën Teach for kosova (TFK);
- Antigona Uka,** Drejtoreshë Ekzekutive, Qendra e Kosovës për Arsim në Distancë (Kosovo Center for Distance Education – KCDE).

Përmbajtja e diskutimit në EduPod 1 është hartuar në bashkëpunim të ngushtë mes ekspertes së angazhuar si konsulente për të realizuar këtë podcast dhe menaxheres së projektit IDEA 2022. Kështu, ishin paraparë një numër i ekuilibruar i pyetjeve për secilën mysafire në lidhje me përvojat e secilës me mësimin në distancë. Duke pasur parasysh parimet e barazisë gjinore, plani fillestar për 4 mysafirë/e me përfaqësim të barabartë (2 gra/vajza, 2 burra/djem) u desh të ndryshohej për shkak të pamundësisë së pjesëmarrësve në momentin e fundit. Podcasti zgjati 45 minuta, dhe gjatë gjithë diskutimit moderatorja u përkujdes që t'u jepte hapësirë të barabartë të ftuarave për të shprehur mendimet e tyre.



EduPod 1

është shfaqur me livestream nga faqja e Qendës për Arsim e Kosovës (KEC) në Facebook, dhe deri me 31 mars 2022 ka arritur



2,193
shikues



537
prej tyre

kanë reaguar dhe/ose komentuar dhe e kanë përcjellë ose shpërndarë më tej postimin.

Ndërkaq, vetëm në 24 orët e para ka tërhequr rreth



1,000
shikime.

Regjistrimi i podcastit në version audio dhe video është publikuar në kanalin e KEC-it në YouTube, dhe regjistrimi në version audio (mp3) është transmetuar në Radio Kosova më 30 mars 2022, në ora 17:00. EduPod 1 mund të ndiqet në çdo kohë duke klikuar në vegzat e mëposhtme:



Faqja e KEC-it në Facebook:

<https://www.facebook.com/QendraperArsimeKosoves/videos/547830560552283>



Kanali zyrtar i KEC-it në YouTube:

<https://www.youtube.com/watch?v=tQaZDvTK4jk&t=6s>

Dy prej pjesëmarrësve në podcast bëjnë pjesë në organizatat e shoqërisë civile Kosovo Center for Distance Education (KCDE) dhe Teach for Kosova (TFK), ku të dyja këto organizata janë anëtare të rrjetit joformal të OSHC-ve të arsimit parauniversitar i themeluar në kuadër të Projektit IDEA 2022. Aktivitetet e këtij rrjeti do të përfshijnë punën e shoqërisë edukativo-arsimore të quajtur Education Podcast Society (EPS), e cila do të ketë në qendër debatet e podcasteve. Rezultatet e identifikuara nga ky podcast i realizuar, si dhe katër podcastet e ardhshme që do të zhvillohen në kuadër të projektit IDEA 2022, do të analizohen dhe trajtohen nga EPS, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta nga përfaqësuesit e rrjetit dhe inicimit në nismave avokuese në fushën e arsimit.

Diskutimet

Gjatë pjesës së parë të këtij podkasti, mysafiret diskutuan në përgjithësi rreth sfidave të hasura gjatë organizimit dhe zhvillimit të mësimin në distancë, si zgjidhje e ofruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës për shkak të përhapjes së pandemisë Covid-19 në vitin 2020. Në pjesën e dytë, të ftuarat theksuan mundësitë e shfaqura gjatë këtij rrugëtimi dhe përparësitë e mësimin në distancë krahasuar me mësimin me prezencë fizike në klasë.

Nxënësja Lisa Lohaj tregoi se situata e pandemisë ka qenë mjaft sfiduese për të, që nga gjendja e frikshme e krijuar në shoqëri e deri tek përdorimi i pajisjeve digjitale dhe platformave të ndryshme online. Ajo u shpreh se mësimi online nuk i ka pëlqyer shumë fillimisht, por më pas e kishte përqafuar duke ditur se mësimi nga shtëpia kishte për qëllim t'i mbronte njerëzit nga virusi, dhe kjo e ka bërë të përballueshme situatën. Vështirësia kryesore që theksoi Lisa gjatë këtij podkasti ka qenë përdorimi i platformave të ndryshme online për mbajtjen e mësimin, të cilat për herë të parë i kanë përdorur gjatë pandemisë. Lisa gjithashtu vlerësoi mbështetjen e marrë nga prindërit dhe mësimdhënësit për të përvetësuar përdorimin e këtyre platformave. Nxënësja gjithashtu tregoi se ka shikuar edhe video të ndryshme udhëzuese në internet se si të përdoren këto platforma, duke pohuar se platforma Zoom ka qenë më e lehta për përdorim.

Sa u përket përparësive të mësimin në distancë, Lisa tregoi se kjo metodë ofron mundësi për të zhvilluar më shumë aftësitë digjitale, hulumtuese, si dhe zhvillimin e autonomisë në të nxënë. Nga ana tjetër, meqenëse mësimi në distancë zhvillohet në kushtet e shtëpisë, gjasat për shpërqendrim gjatë orës mësimore janë më të mëdha për shkak të ambientit familjar dhe mungesës së privatësisë gjatë periudhës së mësimin.

Lisa ceku faktin se, sado që gjenerata e saj e përdor internetin më shumë se të gjithë brezat e kaluar, prapë se prapë ajo dhe bashkëmoshatarët/et e saj nuk janë të përgatitur aq sa duhet në përdorimin efektiv të platformave elektronike për qëllime edukativo-arsimore. Në fund, ajo shtoi se nuk do ta kishte zëvendësuar mësimin në klasë me mësimin në distancë, për shkak se, sipas saj, ambienti i shkollës në përgjithësi dhe prezenca fizike e mësimdhënësve, shokëve/shoqeve në veçanti e bëjnë klasën një ambient më të përshtatshëm për punë dhe mësim.

Mësimdhënësja Arta Demolli nga shkolla "Model" në Prishtinë tregoi se shkolla e saj ka filluar ofrimin e mësimin online 10 ditë pas shpalljes së Covid-19 si pandemi globale nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Konkretisht, shkolla e saj ka përdorur platformën Zoom dhe pastaj e-shkollorin. Si sfidë kryesore Arta përmendi mungesën e pajisjeve teknologjike tek nxënësit/et, gjë që e ka pamundësuar prezencën e shumë prej tyre në klasat virtuale. Kjo ka bërë që pjesëmarrja e nxënësve/eve në mësim online të mos ishte gjithmonë në nivel të kënaqshëm, sado që shumë nxënës/e i kanë përcjellë videot e paraqitura në radio televizionin publik të Kosovës. Kjo mënyrë, sipas Artës, ka ndihmuar që shumica e nxënësve/eve të kishin mundësinë për të ndjekur mësimin nga shtëpia. Arta tregoi po ashtu se, për shkak të mungesës së kompetencës digjitale tek komuniteti arsimor, shpeshherë orët virtuale kanë qenë monotone për nxënësit.

Ndërsa si përparësi të mësimin në distancë Arta theksoi zhvillimin e aftësive digjitale tek kolegët/et e saj, ashtu si edhe tek nxënësit/et. Ajo tregoi se para pandemisë mësimdhënësit/et nuk e kanë përdorur teknologjinë si mjet gjatë procesit mësimor, ndërsa tani edhe pas kthimit në shkollë përdorimi i teknologjisë është bërë normë dhe një standard i ri i vendosur në shkollën e tyre. Arta tha se tani stafi i shkollës së saj mbajnë takime të ndryshme online, duke përfshirë këtu edhe trajnime të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimdhënësve/eve. Nga ana tjetër, edhe nxënësit tani e përdorin më shumë teknologjinë për hulumtime në kuadër të lëndëve shkollore. Gjatë viteve 2016-2017 shkolla e saj ka përdorur platformën SchoolMe të KEC-it, e cila ka ofruar materiale mësimore dhe mënyra për testimin e njohurive të nxënësve/eve. Kjo konsiderohet se ka shërbyer deri diku si parapërgatitje për mësimin virtual.

Ndërkohë, në shumë raste mësimi online ka mundësuar vendosjen e lidhjeve direkte mes mësimdhënësit/es dhe nxënësit/es në mënyrë më të afërt dhe të individualizuar – diçka që nuk ka ndodhur më parë gjatë mësimin të zakonshëm në klasë. Kjo e ka lehtësuar komunikimin dhe ka krijuar afërsi, duke lehtësuar mësimin dhe ofrimin e mbështetjes.

Arta shpjegoi se ajo nuk ka ndjekur ndonjë trajnim që ka të bëjë me zhvillimin e aftësive digjitale tek mësimdhënësit/et, dhe theksoi se një trajnim i tillë do të ishte shumë i mirëseardhur. Sipas saj, me trajnime të tilla mësimdhënësit/et do të sigurt/a në përdorimin e teknologjisë dhe ofrimin e mësimin cilësor dhe efektiv në distancë.

Nga perspektiva e saj si **nënë, Anita Plakolli**, njëherësh anëtare e Kryesisë së Këshillit të Prindërve, ngriti disa problematika dhe sfida. Fillimisht ishte thellimi i pabarazive tek nxënësit/et si pasojë e pandemisë Covid-19, më tej situata enigmatike që shqetësonte fëmijët, si dhe papërgatitja e sistemit arsimor të Kosovës për situata të jashtëzakonshme. Sipas Anitës, pengesa kryesore e mësimin online gjatë pandemisë ka qenë përdorimi i disa platformave të ndryshme nga shkollat. Në këtë mënyrë si fëmijët, ashtu edhe prindërit e kanë pasur të vështirë të njohin përdorimin e të gjitha platformave. Anita theksoi se fëmijët e saj kanë pasur nevojë për asistencë të vazhdueshme gjatë mësimin online, për shkak se shpesh ka ndodhur që e-shkollori të mos funksionojë dhe ora virtuale të vazhdojë në ndonjë platformë tjetër.

Sa i përket përdorimit të Viber nga mësimdhënësit/et për të komunikuar me nxënësit/et, Anita tha se nuk e ka përkrahur këtë ide. Kjo nuk është mirëpritur nga disa prindër për shkak se ata janë shqetësuar në vazhdimësi nga mesazhet dhe nuk janë respektuar politikat për mbrojtjen e fëmijëve. Ajo tregoi se disa fëmijë janë kontaktuar në Viber edhe pa lejen e prindërve.

Nga ana tjetër, sa i përket funksionimit të trekëndëshit nxënës-mësimdhënës-prindër, Anita pohoi se ky trekëndësh është forcuar gjatë kohës së pandemisë, sepse të gjitha palët e kanë kuptuar më mirë punën e njëra-tjetrës dhe janë vetëdijësuar më shumë për rolin dhe rëndësinë e secilit/ës. Ajo tregoi se ajo si nënë ka pasur mundësi t'i shohë në kohë reale vështirësitë me të cilat janë përballur mësimdhënësit/et gjatë mësimin virtual, përfshirë mbajtjen e vëmendjes së nxënësve/eve, ruajtjen e atmosferës së klasës etj. Kështu, pandemia ka nxjerrë në pah vlerat e atyre mësimdhënësve/e që janë treguar të zellshëm/shme dhe kreativë/e në ato kushte. Ata/ato gjatë kësaj kohe kanë bërë maksimumin për të mbajtur nxënësit/et të interesuar/a dhe të informuar/a me aq mundësi sa kanë pasur, ndërkohë që prindërit janë detyruar të punojnë edhe më shumë me fëmijët e tyre për të krijuar kushtet e përshtatshme për zhvillimin e pandërprerë të procesit mësimor.

Anita po ashtu nënvizoi se, në epokën të cilën po jetojmë, gjithsesi duhet të ofrohet edhe mësimi në distancë krahas atij në klasë. Ajo beson se mësimi hibrid, disa ditë në shkollë e disa ditë në shtëpi, do të ishte një kombinim i duhur për të zhvilluar aftësitë e shekullit të 21-të tek nxënësit/et. Ajo beson se një gjë e tillë është e mundur nëse institucionet shtetërore do të fokusoheshin më shumë në këtë sferë.

Antigona Ukaj nga KCDE rikonfirmoi që në hulumtimet e zhvilluara nga qendra e tyre kanë dalë po të njëjtat argumente mbi vështirësitë e mësimi online, duke përfshirë frikën e nxënësve nga situata e krijuar, mungesën e pajisjeve digjitale, si dhe mos-përgatitjen adekuate të mësimdhënësve për mësim në distancë. Antigona theksoi se afro 4-5 % e nxënësve/eve në 12 komunat më të mëdha të Kosovës nuk kanë vijuar fare mësimin gjatë pandemisë pikërisht për shkak të mungesës së pajisjeve digjitale. Ky fakt në të njëjtën kohë është tregues i situatës së rënduar socio-ekonomike të shoqërisë sonë në këtë periudhë të vështirë e pa precedent.

Si njohëse e mirë e fushës së saj të ekspertizës, Antigona shpjegoi se ka dy lloje të mësimi në distancë: *asinkronik* dhe *sinkronik*. Mësimi asinkronik është strategji mësimore që nuk kërkon ndërveprim në kohë reale, ku nxënësit/et mund të ndërveprojnë me përmbajtjen e lëndës kurdo që ata/ato dëshirojnë. Ndërsa mësimi sinkronik i referohet mësimi në të njëjtën kohë por jo nga i njëjti vend, thënë ndryshe mësimi virtual apo e-learning. Të dyja këto forma mund të shfrytëzohen duke u kombinuar me njëra-tjetrën dhe me mësimin në klasë njëkohësisht. Antigona vuri në dukje se studimet e zhvilluara e mbështesin idenë e mësimi të kombinuar, dhe se nxënësit/et që ekspozohen ndaj mësimi të kombinuar kanë arritje më të larta. Ndërkohë, nxënësit/et në Kosovë janë gjenerata e lindur dhe rritur në botën digjitale (ang. *digital natives*) dhe janë në gjendje t'i marrin informatat në mënyrë efektive përmes platformave elektronike.

Antigona tërhoqi vëmendjen drejt rëndësisë së digjitalizimit të sistemit arsimor, duke shtuar se ky proces ka karakter shumëdimensional i cili nuk përfshin vetëm kapërcimin e thjeshtë nga mësimi tradicional tek mësimi në distancë, por edhe sigurimin e infrastrukturës, shfrytëzimin e softuerit përkatës, përgatitjen e mësimdhënësve/eve dhe palëve të tjera, si dhe sigurimin e materialeve të nevojshme. Konkretisht, KCDE është duke e promovuar idenë që shkollat në Kosovë të ofrojnë së paku dy lëndë në mënyrë virtuale gjatë vitit shkollor, sepse kështu edhe përfitimi i aftësive digjitale do të ndodhë në mënyrë të natyrshme. KCDE gjithashtu që nga muaji gusht i vitit 2021 ofron edhe trajnimin për mësimdhënës/e “*Mësimdhënia online në nivelin e duhur*”, për të cilin sipas Antigonës ka shumë interesim nga ana e mësimdhënësve/eve. Deri tani janë trajnuar 60 mësimdhënës/e, por kërkesat janë shumë të mëdha, ku janë pranuar mbi 700 aplikime. Shpresohet se organizata të tjera do t'i bashkohen këtyre përpjekjeve, në mënyrë që të mbulohen kërkesat.

Për fund, Antigona ritheksoi se digjitalizimi është shumëdimensional, dhe kërkon pajisje, infrastrukturë, rregullim, udhëzime përdorimi, dhe trajnime. Është parë se fëmijët që kanë pasur qasje të hershme në teknologji sot janë inxhinierë softueri dhe paguhen shumë mirë. Kjo është epoka në të cilën jetojmë, dhe shteti duhet ta konsiderojë këtë duke e parë si përparësi në kuadër të zhvillimit ekonomik të vendit. Konkretisht, të rinjtë e të rejtat tona po i shesin aftësitë e tyre digjitale jashtë vendit, dhe do të ishte përparësi për Kosovën nëse ata/ato i vënë aftësitë e tyre në shërbim të vendit të vet. Ky është përfitimi më i madh i digjitalizimit.

Përfundime

Pjesëmarrëset në EduPod 1 ishin dakord me faktin që kombinimi i mësimin virtual me mësimin me prezencë fizike në klasë është mënyra më e mirë për të shkuar përpara. Përparësitë e një kombinimi të tillë janë të shumëfishta, dhe dobia e tyre është afatgjatë.

Mësimi virtual:

- Ofron mundësi të shumta për zhvillimin e shkathtësive të nxënësve/eve dhe mësimdhënësve/eve në përdorimin e teknologjisë për qëllime edukativo-arsimore;
- Krijon hapësirë për zhvillimin e shkathtësive të hulumtimit për nxënësit/et;
- Rrit ndjenjën e autonomisë dhe vetëbesimin tek nxënësit/et gjatë procesit të përvetësimit të dijeve;
- I përgatit fëmijët për t'iu bashkuar komunitetit global të edukimit virtual, dhe më tej tregut global të punës kur të rriten.

Mësimi real me prezencë fizike në klasë:

- Ofron kushte për socializimin e vazhdueshëm të nxënësve/eve me bashkëmoshatarët/et, si element i rëndësishëm i zhvillimit të shëndoshë psiko-social të fëmijëve;
- Ndhmon në realizimin konkret të orëve në lëndë të caktuara, siç është edukata fizike apo orë të tjera me karakter praktik;
- Krijon mundësi për përdorimin e metodave individuale të mësimdhënies, çka u shërben kryesisht fëmijëve me nevoja të veçanta, nxënësve/eve që mësojnë më efektivisht në klasë sesa virtualisht etj.



Funded by
the European Union

